



# PIRANJAT

📍 piranjatofficial 📞 piranjat  
✉️ piranjatshow@gmail.com  
🌐 www.piranjat.al  
📍 Rr. Aleksandër Moisiu, Kinostudio  
Tiranë AA Company  
☎️ +355 68 43 43 444

Tiranë më, 28 Gusht 2025

Drejtuar: Z. Gentian Sala

Kryetar

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Përshëndetje z. Sala,

Në disa media online por edhe në redaksinë e emisionit “Piranjat” kanë mbërritur ankesa/denoncime nga qytetarë, lidhur me një platformë të rreme investimi që quhet TXEX. Informacionet paraprake janë se kjo është një skemë e mirëfilltë piramidale që operon pa licensë dhe jashtë çdo ligji në vendin tonë. Personat që drejtojnë këtë platformë të rreme kanë shfrytëzuar aplikacionet sociale si “Instagram”, “Telegram”, “Signal”, “Whatsapp” për të mashtruar njerëzit, që të investojnë me premtimin se do marrin para mbrapsht, por i gënjejnë. Shqetësimet e qytetarëve lidhen edhe me përhapjen e numrave të ID dhe fotove personale (të cilat u kërkohen qytetarëve nga personat e përfshirë në këtë skemë).

Duke u mbështetur në Ligjin Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit,” dhe në përputhje me nenet e këtij ligji, i cili rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike, ju drejtohem me këtë kërkesë për të marrë informacionin e mëposhtëm:

1. A keni dijeni për këtë skemë mashtrimi dhe cili është roli i institucionit tuaj në bashkëpunim me institucionet e tjera për këtë çështje?
2. Çfarë sigurie i jep institucioni juaj qytetarëve se të dhënat e tyre nuk do të keqpërdoren dhe çfarë masash merrni nëse ndodh diçka e tillë?

Bazuar në detyrimet ligjore për transparencë dhe në të drejtën e qytetarëve për t'u informuar, presim që të na mundësoni informacionin e kërkuar brenda afatit të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi.

Duke ju falënderuar paraprakisht për bashkëpunimin, mbetemi në pritje të një përgjigjeje sa më të shpejtë nga ana Juaj.

Me respekt,

